



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:093728

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05740212

KA.nr.406/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Patroni” ShPK me NUI 811254797 dhe seli në fshatin Astrazup në Malishevë, i cili sipas prokurës përfaqësohet nga avokatët Naim Spahiu, Samire Bajgora dhe Agnesa Abdyli me seli në rrugën Dëshmorët e Ponoshecit, ish Fabrika e Radiatorëve, zyra nr. 6 në Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Inspektorati i Tregut me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 16.05.2024 në të cilën mori pjesë përfaqësuesi i paditësit, ndërsa i padituri nuk mori pjesë, më 27 maj 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Patroni” ShPK me NUI 811254797 ndaj të paditurit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Inspektorati i Tregut, me të cilën ka kërkuar anulimin e akti administrativ nr. ref. 19/20 i datës 20.08.2020 i të paditurit.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale të shkaktuara në këtë konflikt administrativ.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 14.09.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e aktit administrativ nr. 19/20 i datës 20.08.2020 të Inspektoratit të Tregut.
2. Ai në padi po edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka pretenduar se me rastin e shqiptimit të gjobës nuk e ka marrë për bazë që në atë kohë kemi qenë të mbyllur për

shkak të pandemisë dhe kur Qeveria ka vendosur masat kufizuese dhe ka qenë e pamundur që në afatin e paraparë ligjor të pajiset me dokumentet e kërkuara. Sipas tij, meqenëse ATK ka bërë shlyerjen e obligimeve tatimore për shkak të pandemisë, atëherë për këtë arsye nuk ka mund të siguroj nga ATK dokumentin që nuk ka pasur obligime tatimore. Ka shtuar se vendimi i goditur ka edhe shkelje të procedurës administrative, përkatësisht të parimit të objektivitetit dhe paanshmërisë, pasi nuk i është dhënë pesha e duhur të gjitha fakteve në lidhje me problematikën e kësaj lënde gjë që është në kundërshtim me nenin 89 të LPPA-së.

3. I Padituri në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë, ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor nuk mori fare pjesë, ndonëse ishte ftuar me rregull. Sipas tij, vendimi i goditur nuk është përcjellë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, si drejtë është aplikuar e drejta materiale dhe procedurale.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

4. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi nr. ref. 19 i datës 20.08.2020 i të paditurit dhe shkresat e lëndës të procedurës administrative të dorëzuara nga i padituri përmes përgjigjes në padi sipas nenit 37.2 lidhur me nenin 43.1 të LKA-së.
5. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
6. Inspektorati i Tregut në shkallën e parë më 22.06.2020 e kishte inspektuar lokalitë e të Paditësit në Astrazup të Malisevës dhe kishte konstatuar që Paditësi nuk e licencë valide për shitjen me pakicë të naftës dhe benzinës, rrjedhimisht e kishte detyruar atë që brenda afatit prej 30 ditëve t'ia dorëzoi licencën për shitje me pakicë, raportin e kalibrimit (verifikimit të mjetit matës të rrjedhjes për benzinë dhe naftë) dhe faturën e fundit të furnizimit me naftë dhe benzinë. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes procesverbalit nr. 001364 të datës 22.06.2020.

7. Nuk ishte kontestuese ndemjet ndërgjyqësve se Paditësi nuk ia kishte dorëzuar të Paditurit dokumentet e kërkuara brenda afatit të caktuar. Meqenëse kështu, atëherë Inspektoratit të Tregut më 24.03.2020 duke vepruar në shkallë të parë kishte nxjerrë aktvendimin ref. 19/20 të datës 24.07.2020, me të cilin i kishte shqiptuar Paditësit gjobë në shumë prej 1000€ për mos dorëzim të dokumenteve të kërkuara. Këtë fakt gjykata e konstatoi përmes aktit administrativ të sapo cekur.
8. Më 05.08.2020 Paditësi kishte ushtruar ankesë kundër vendimit të shkallës së parë, ndërsa Kryeinspektori i Inspektoratit të Tregut si shkallë e dytë përmes vendimit të goditur ref. 19 të datës 20.08.2020 dhe e ka vërtetuar aktin administrativ të shkallës së parë.
9. Gjykata sqaron se Paditësi, si palë me barrën e provës në bazë të nenit 322 para. 2 të LPK-së, nuk arriti të vërtetoj se dokumentet, të cilat ia ka kërkuara i Padituri, nuk i ka disponuar vet dhe se është dashur t'i siguroj nga një autoritet publik, i cili për shkak të rrethanave të pandemisë nuk ka punuar.

III. Vlerësimi meritor i rastit

10. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e pabazuar në ligj.
11. Gjykata vlerësoi se i Padituri e ka zbatuar procedurën administrative në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat procedurale të paraparë me ligjet e veçanta, të cekur në këtë aktgjykim. Për më tepër, gjykata vlerëson se vendimi i goditur e ka formën e aktit administrativ në përputhje me nenin 47 të LPPA-së si dhe arsyetimi i tij i përmban të gjitha informacionet dhe sqarimet e kërkuara me nenin 48 të LPPA-së. Gjykata e vlerësoi si të pabazuar pretendimin e Paditësit se vendimi i goditur është nxjerr në kundërshtim me parimin e objektivitetit, meqenëse anshmëria e të Padituri nuk është provuar me prova e as nuk rrjedh nga vendimi i goditur.
12. Po ashtu, gjykata vëren se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike. Gjykata rikujton se Paditësi nuk ka sjellë prova nga të cilat rrjedh se ka pasur pengesa në sigurimin e dokumenteve të kërkuara. Për më tepër, gjykata vlerëson se dokumentet e kërkuara nga i Padituri janë dokumente, të cilat çdo shoqëri

tregtare e ngjashme i ka në posedim dhe nuk është e nevojshme që të pajiset rishtazi me ato nga një autoritet publik. Kështu, licencën e kërkuara Paditësi e ka pranuar në momentin e licencimin, raportin e verifikimit të mjetit matës të rrjedhjes për benzinë dhe naftë e ka pranuar me rastin e verifikimit, si dhe me faturën e fundit të furnizimit me benzinë dhe naftë Paditësi është pajisur kur ishte furnizuar me atë karburant. Pra, asnjërin nga këto dokumente Paditësi nuk ka pasur nevojë që ta marrë përsëri nga autoriteti kompetent publik.

13. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Gjendja faktike e përshkruar më lart rregullohet me nenin 14 të Ligjit 03/L181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut (këtu e tutje LIMT), i cili në para. 2 ka përcaktuar se *“Subjekti ekonomik sipas kërkesës së inspektorit, është i detyruar që menjëherë t’i ofroi të dhënat e mundshme e të nevojshme, ndërsa për raste të shtyshme sipas vlerësimit, brenda afatit të përcaktuar nga inspektori”*, ndërsa në para. 3 të po të njëjtit nen ka përcaktuar se *“Subjekti ekonomik i cili mbikëqyret konsiderohet që nuk i ka mundësuar inspektorit kryerjen e mbikëqyrjes nga paragrafi 1. i këtij neni nëse edhe brenda afatit të përcaktuar me procesverbalin e inspektorëve, nuk siguron qasje në produkte, dokumentacionin e kërkuar të punës dhe dokumente tjera të nevojshme për të konstatuar gjendjen faktike të mbikëqyrjes së filluar”*. Sipas këtyre dispozitave, Inspektorati Tregut ka të drejtë që t’i lejoj një subjekti ekonomik që në afatin e caktuar nga ai t’ia dorëzoj dokumentet, në të cilat ka kërkuar që të ketë qasje por që kanë munguar me rastin e inspektimit, ndërsa nëse subjekti ekonomik nuk vepron brenda afatit të caktuar nga Inspektorati i Tregut, atëherë konsiderohet se nuk i ka mundësuar qasje Inspektorati i Tregut.
14. Gjithashtu sipas nenit 33 para. 1 të LIMT-së (i ndryshuar) *“Inspektori i tregut për shkeljet e konstatuara me këtë ligj i shqipton gjobat në vijim: 1.1. me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, ndëshkohet personi juridik për shkeljet e përcaktuara në nenin 14 të ligjit bazik”*. Kjo nënkupton se, nëse personit juridik nuk i mundëson qasje Inspektoratit të Tregut sipas nenit 14 të LIMT-së, pra edhe pas mundësisë që dokumentin e kërkuar ta dorëzoj brenda afatit të caktuar, atëherë ai gjobitet në shumën e paraparë në atë paragraf.
15. Prandaj, meqenëse Paditësi nuk ia ka dorëzuar me kohë Inspektoratit të Tregtisë dokumentin e kërkuar, atëherë ky i fundit me të drejtë i ka shqiptuar gjobë me aktin

administrativ të shkallës së parë, ndërsa në shkallë të dytë me të drejtë është refuzuar ankesa e Paditësit.

16. Gjykata sqaron se meqenëse i Padituri e ka shqiptuar sanksionin më të butë të mundshëm, atëherë gjykata vlerëson se edhe trajtimi i proporcionalitetit të gjobës me shkeljen e konstatuar është i panevojshëm
17. Prandaj, meqenëse i Padituri ka qenë kompetent për të nxjerr vendimin e goditur, procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se i Padituri ka dhënë arsytim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, duke marrë parasysh se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsytim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjore nga LPPA dhe LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit.
18. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së, meqenëse Paditësi e kishte kërkuar shpërblimin e tyre përmes padisë.
19. Bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të LKA, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.406/2022

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.